



02/Nr. 8829 /2018
Data: 17.10. 2018

PROCESVERBAL I KKSb-së

Nga mbledhja e nëntë - IX- për vitin 2018 mbajtur me datë: 28.09.2018 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Mallzum Qajani** (Nënkrytarë i Komunës) **Shpend Bela** (përfaqësues i stacionit policor), **Afrim Mustafa** (përfaqësues i policisë kufitare –vija e gjelbërt), **Menduh Vlasi** (përfaqësues i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport), **Ali Vishi** (përfaqësues i FSK-së), **Refet Kalisi** (përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë), **Isa Shkreta** (përfaqësues i E.V.S.B), **Isni Bushi** (përfaqësues i këshillit të prindërve), **Nustret Shiti** (përfaqësues i këshillit të bashkësisë islame në Han të Elezit), **Amir Bushi** (përfaqësues nga zyra për barazi gjinore), **Bashkim Sopa** (zyrtar për informim).

Takimin e kryesoj kryetari i komunës z. **Rufki Suma**.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.
3. Të ndryshme.

Rufki Suma pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rufki Suma a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.

Rufki Suma lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shpend Bela gjatë këtij muaji kemi pas 9 (nëntë) raste. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji dhe nuk ka pas ndonjë element që e rrezikon sigurinë. Jemi duke u munduar me i zbatuar planet operative të cilat janë në fuqi.

Afrim Mustafa gjatë këtij muaji kemi pas 1 (një) raste. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

Amir Bushi në lagjet tonë kemi pas shqetësim, e gjitha lagja për shkak të disa vjedhjeve që janë bërë dhe rast konkret ka ndodhë edhe në shtëpinë time më është bërë vjedhje. Ne kemi njoftuar policinë, mirëpo personi i cili ka kryer vjedhje është i rrezikshëm dhe me vete bartë edhe armë të ftohta dhe mund të pëson lëndime dikush prej tij sepse ka edhe probleme psikike. Është mirë që policia me vepruar për shkak se edhe fëmijët janë të rrezikuar nga ai.

Shpend Bela autoritet që e autorizon policinë për me marr veprime qoftë me caktuar për me arrestuar apo me caktuar paraburgim është prokurori i shtetit.

Isni Bushi ankesa nga nxënësit ka për qenët endacak. Drejtori i shkollës së mesme “Dardania” ka bërë zgjidhje për çështje të parkingut dhe nuk ka ankesa nga banorët e asaj lagje, mirëpo edhe nxënësit të cilët shkojnë në shkollë fillore nuk kanë pengesë. Policia mund të vepron në bazë të ligjit për veturat të cilën parkohen rreth oborrit të shkollës.

Rufki Suma komuna e ka rregulluar parkingun zyrtarë dhe policia duhet të vepron në bazë të ligjit për veturat të cilët parkohen në vendet të cilat janë të ndaluara.

Nustret Shiti në magjistrale nuk ka shenjë që njofton që ka shkollë por është vetëm një shenjë që e përcakton shpejtësinë katërdhjetë në orë. Është mirë të vendoset shenja që tregon që ka shkollë. Çështja e vjedhjeve ka zënë me u bërë alarmante dhe nuk po jena të sigurt. Ankesë kam pas nga qytetarët për rasti e vjedhjes së shitores së ndërmarrjes “Atlas” sepse gjithë e dimë që jena nën monitorim të kamerave dhe policia nuk e ka parë. Të gjithë krenohemi që monitorohemi me kamera atëherë shtrohet pyetja se çfarë dobie ka kamera. Në lagjen tonë është duke u hapur një bastore dhe në bazë të normave ligjore që është largësia nga shkollat duhet të jetë pesëqind metra ajo nuk i përmbushë kushtet për shkak se largësia nga shkolla fillore “Ilaz Thaçi” e deri te bastorja nuk besoj që është më shumë se treqind metra. Hapja e bastores paraqet rrezik për shkak se është afër vendbanimit dhe personat mund të dëshpërohen nga humbja e mund të vjen deri te kacafytja në mes vete. Kërkoj nga autoritete komunale dhe nga policia që ajo bastore me u larguar prej atyhit për shkak se e rrezikon sigurinë tonë.

Rufki Suma ne kemi marr vendim dhe i kemi larguar bastoret por ligji nga niveli qendrorë po i mbron. Bastoret pajisen me licencë nga niveli qendrorë dhe potencojnë që niveli lokal nuk ka drejtë me na penguar. Ne vazhdimisht jemi munduar me i ndal por po kemi probleme për shkak se me dokumentacion pajisen nga niveli qendrorë. Për bastoren në fjalë që u përmendë duhet ta shikojmë distancë që e parasheh ligji dhe dokumentacionet që kërkohen. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka si vlerësim i përgjithshëm është se gjendja e sigurisë në komunën e Hanit të Elezit është e mirë.

3. Të ndryshme.

Rufki Suma lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Isa Shkreta banorët e fshatit Gorancë kanë kërkuar që të shtohet numri i vendosjes së kamerave.

Rufki Suma kamera kemi vendos vetëm nëpër udhëkryqe dhe pika kyçe sepse policia i ka përcaktuar pikat për vendosjen e kamerave.

Isni Bushi po kemi probleme në lagjen tonë për shkak të veturave të ndryshme që qarkullojnë me shpejtësi dhe paraqesin rrezik për banorët të cilët jetojnë aty. Kërkoj nga policia që të vepron edhe në atë pjesë. Duhet komuna që të del në vend ngjarjes për shkak se kompania “Bektelenka” po punon edhe natën dhe afër shtëpisë sime në ora dy të natës kamioni është përmbysë.

Rufki Suma është dashur edhe ju si banorë me u organizuar me dal dhe me njoftuar edhe policinë. A keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 14: 55 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



